

e thyer në shtëpinë e Jasharit, erdhi një makinë me pjesëtarë të forcave serbe, që ishin të veshur në uniforma me ngjyrë të mbyllur. Makina u ndal para shtëpisë së Jasharit, ndërkaq pjesëtarët e forcave serbe hapën zjarr pa paralajmërim. Jasharin e qëlluan për vdekje në shpinë, ndërkaq Lumi arriti të ikte me vrap. Në mbrëmje, Lumi u kthye dhe me ndihmën e disa banorëve e kanë varrosur Jasharin në varrezat e fshatit fqinj të Maralisë/Maralija.

Burimet: deklarata A.P, FDH-34642; deklarata V.P, FDH-12287; fotografi, FDH-35338.

Ramiz (Maliq) Mazreku

(21.01.1944, shqiptar nga Malisheva/Mališevo, punëtor, pesë fëmijë)

Ramizi punonte në ndërmarrjen *Zhitopro-met/Zitopromet* në Malishevë/Mališevo. Në muajin maj të vitit 1998, djemtë e Ramizit i çuan familjet e veta në Pagarushë/Pagaruša, ndërkaq Ramizi mbeti në shtëpi. Më vonë, edhe ai e braktisi fshatin dhe u strehua në Lladroc/Ladrovac. Në datën 25.07.1998, në afërsi të Llapushnikut/Lapušnik filluan konfliktet ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Njëherësh, forcat serbe e nisën edhe ofensivën kundër fshatave në rrethinën e Malishevës/Mališevo. Kjo e detyroi Ramizin që me vëllezërit Zeqirin dhe Ejupin të niseshin më 30.07.1998, nga Lladroci/Ladrovac për në Pagarushë/Pagaruša, ku ishin të strehuara familjet e tyre. Tre pjesëtarët e UÇK-së u nisën me ta. Në afërsi të *Mëhallës së Gurit/Kamenita mahala* [Malishevë/Mališevo], pjesëtarët e forcave serbe kanë shtënë ndaj tyre. Ramizi u plagos rëndë, përdërisa të tjerë u larguan me vrap nga vendi i ngjarjes. Djali i Ramizit, Maliqi, ka tentuar që gjatë natës të shkonte dhe ta marrte trupin e pajetë të të atit, por pa sukses. Prania e forcave serbe ende ishte e madhe. Familjarët nuk dinin një kohë të gjatë çfarë kishte ndodhur me trupin e Ramizit. Pas lufte, ashkaliu Nazif Mazreku u ka treguar atyre se, më 3 apo 04.08.1998, ai e ka varrosur Ramizin në Malishevë/Mališevo, në bazë të urdhrat të policisë serbe. Në datën 6.08.1999, familjarët e kanë zhvarrosur varrin, të cilin Nazifi e kishte identifikuar si të Ramizit. E identifikuan

Ramizin në bazë të rrobave. Duart i kishte të lidhura me tel, ndërkaq me të në të njëjtin varr ishte i varrosur edhe Ismet Krasniqi [të shikohet regjistrimi]. Po atë ditë, mbetjet mortore të Ramizit u varrosën në Malishevë/Mališevo, në afërsi të vendit ku u zhvarrosën.

Burimet: deklarata M.M, FDH-18114; deklarata E.K, FDH-15664; FHP, *Regjistri...*, FDH-859.

Islam (Rexhep) Morina

(1930, shqiptar nga Astrazupi/Ostrozub, komuna Malishevës/Mališevo, bujk, pesë fëmijë)

Banorët e Astrazupit/Ostrozub, më 26.07.1998, e braktisën fshatin dhe shkuan në malet, ku Islami dhe miqtë e tij, Idrizi dhe Nuhiu, u kujdeseshin për bagëtinë. Islami e tymoste duhanin me pasion. Në mëngjes, më 30.07.1998, rreth orës 11:00, ai u kthye në **Astrazup/Ostrozub** për tu furnizuar me sasi të reja të duhanit. Ngase nuk u kthye deri në orët e vona të mbrëmjes, disa djem të rinj shkuan në fshat për të parë çfarë ka ndodhur më të. E gjetën trupin e pajetë të Islamit te kapia e shtëpisë së tij. Në oborr kishte shumë gëzhoja. Islamit e varrosën në të njëjtin mbrëmje në livadhin e tij, në afërsi të pyllit të quajtur *Majat e Kikës*. Pas lufte, më 18.10.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Islamit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Dragobil/Dragobilje.

Burimi: deklarata N.R, FDH-15658.

Zlatko (Petar) Petrović

(4.06.1960, serb nga Kormnjani i Epërm/Gornje Korminjane, komuna e Kamenicës/Kosovska Kamenica, teknik i kimisë, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Zlatko e ka mbaruar Shkollën e Mesme të Kimisë në Kamenicë/Kosovska Kamenica. Punonte në fabrikën e radiatorëve *Jugoterm* në Gjilan/Gnjilane. Jetonte me bashkëshorten, të vëllain dhe familjen e tij në shtëpinë e përbashkët në Kormnjanin e Epërm/Gornje Korminjane. Nga mesi i muajit korrik, e ka marr ftesën për të shërbyer në forcat rezervë të policisë.